



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2024:056040

Datë: 24.04.2024

Numri i dokumentit: 05612291

C-IV-14-0233

Ankuesi : *Posta dhe Telekom i Kosovës, në Prishtinë.*

Kundër

E paditur : Nsh., Eximkos-Prishtinë, përfaqësuar nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit , rruga Dritan Hoxha nr.55, Lakrishte-Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me gjyqtaren Ganimete Puka, me datën 24.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I:REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e ankuesit *Posta dhe Telekom i Kosovës, sh.a në Prishtinë. Dhe VËRTETOHET vendimi i Autoritet të Likuidimit , nr. PRN092-0175, i datës 18.12.2013, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.*

2. Secila palë i heqë shpenzimet e veta të procedurës.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Ankuesi me datë 14. janar.2014, pranë DHPGJS, ka parashtruar ankesë, kundër vendimit me numër . PRN092-0175, i datës 18.12.2013, të lëshuar nga AL, me të cilin vendim pjesërisht ju është aprovuar kërkesa në shumën prej 855.34 €, ndërsa pjesa tjetër e kërkesës për kompensimin në bazë të faturave të pa paguar në shumën prej 2.686.83€, nga NSH (në likuidim), ju ka refuzuar.

Ankuesi në ankesë ndër të tjera ka theksuar se Autoriteti i Likuidimit ka nxjerrë vendim me të cilin pjesërisht ka refuzuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës në shumën prej 2.686.83€, në emër të borxhit për fatura e pa paguar për shërbimet e kryera për periudhën Mars 2004 deri në Qershor.2006, me arsyetim se nuk ka gjet asnjë dëshmi se parashtruesi ka paraqitur kërkesë në ndonjë gjykatë apo para ndonjë autoriteti tjetër kompetent nga janari 2004, për ta ndërprerë parashikimin, dhe autoriteti i likuidimi e ka nxjerr ketë vendim pa e vërtetuar drejtë gjendjen faktike si dhe ka zbatuar gabimisht të drejtë materiale. Ankuesi pohon se është i pa qëndrueshëm konstatimi i AL, se kërkesa është e parashkruar, në kuptim të dispozitave ligjor nga nenin 387, të ligjit LMD/ të vitit 1978, mirëpo çuditërisht nuk jep arsyet se cila fatura janë të parashkruara.

Ankuesi pretendon se kërkesa e ankuesi është e bazuar në prova dhe ligji, dhe përfundimisht i ka propozuar gjykatës që të anulohet vendimi dhe të atakohet dhe të aprovohet kërkesën e ankuesit si të themeltë dhe të detyrohet pala e padituri, që në emër të kompensimit të borxhit t'ia kompensojë shumën prej 3.542.17 €. Në mbështetje të ankesës, ankuesi nuk ka dorëzuar asnjë provë të vetëm relevante për të vërtetuar pretendime të tij.

Me datë 19.mars.2021, pala kundërshtarë AKP-ja përmes përfaqësuesit të sajë, ka paraqitur mbrojtjen e saj ndaj kërkesës së parashtruar nga ankuesi, në mbrojtjen e parashtruar ndër të tjera ka theksuar se NSH „, Eximkos„, ka hyrë në procedurën e likuidimit me datën 08.05.2007. Me datë 09.01.2014, parashtruesi i kërkesës ka parashtruar një kërkesë, me të cilën ka kërkuar kompensimin e shumës prej 3.542.17€ në emër të detyrimit të pa paguar për periudhën Mars.2004, deri në Qershor 2006, nga ndërmarrja. Autoriteti i Likuidimit e ka shqyrtuar kërkesën e parashtruar nga pala në atë procedurë dhe me vendimin me numër . PRN092-0175, i datës 18.12.2013, kërkesën e parashtruar pjesërisht e ka pranuar në shumën prej 855.34 €, ndërsa pjesën tjetër të kërkesës e ka refuzuar në shumën prej 2.686.83 €. Autoriteti i Likuidimit vendimin e vet e ka bazuar në nenin 2.1 të Deklaratës së transferimit të mjeteve (përfshirë edhe detyrimet), që do të transferohen në NEWCo, ndërsa në nenin B, të shtojcës 6, të Deklaratës së transferimit, specifikohet se mallrat dhe detyrimet e shërbimeve të akumuluar, do të bartet të blerësi. Përfundimisht AKP, i ka propozuar gjykatës që ankesa të refuzohet si të pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit, si i drejt dhe i ligjshëm. Si provë ka dorëzuar vendimin e AL PRN092-0175, dt.18.12.2013, dhe vendimin për emërimin e anëtarëve të AL.

Me 29.mars.2021, gjykata i ka dorëzuar mbrojtjen e AKP-së tek ankuesi PTK, në mënyrë që ai të paraqes përgjigje ndaj mbrojtjes së AKP-së, mbrojtjen ankuesi e ka pranuar me 01.04.2021, mirëpo nuk ka dhënë përgjigje në lidhje me këtë .

Në lidhje me detajet tjera, gjykata i referohet shkresave të lëndës dhe parashtrësive të palëve.

Arsyetimi Ligjor

Kërkesa /ankesa refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se “pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësive apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuar)”, ndërsa pika 3 parasheh se “pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e

tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë”.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Pas shqyrtimit të provave të lëndës parashtrimeve dhe pretendimeve të palëve në procedurë gjykata ka ardhur në përfundimin se ankesa e parashtruar në këtë çështje është e pa bazuar.

Pas shqyrtimit të pretendimeve, parashtrimeve të palëve në procedurë dhe provave të lëndës gjykata ka gjetur se NSH, ka hyrë në procedurë të likuidimit me 08.05.2007. Parashtruesi me 09.01.2014, dorëzoi kërkesës pranë Autoritetit të Likuidimit, që është brenda afati ligjor, me të cilën kërkesë ka kërkuar kompensimin e shumës prej 3542.17 €, në emër të borxhit për shërbimet e telefonisë, nga NSH-ja për periudhën mars.2004 deri qershor 2006. Autoriteti i Likuidimit e ka shqyrtuar kërkesën dhe me vendimin me numër PRN092-0175, të datës 18.12.20013, kërkesën e parashtruar në atë procedurë pjesërisht e ka pranuar dhe atë shumën prej 855.34€, dhe e ka refuzuar shumën prej 2.686.83 € mbi bazën se sipas deklaratës së transferimit të mjeteve, nenin 2. 1 dhe nenin N i shtojcë së 6 të Deklaratës së transferimit, kjo pjesë e borxhit të akumuluar bartet tek blerësi, duke e udhëzuar ankuesin që ti drejtohet ATMCM, ku e kishte transferuar borxhi, mbi këto fakte të pa kontestuar e pala ankuese, ankesa u refuzua.

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet e ankuesit, të ngritura në ankesë me pretendimin se kinse AL është thirru se kërkesë është e parashkruar, gjykata gjënë se ky pretendim fare nuk qëndron, në vendimin e atakuar nuk përmendet fare parashikimi, andaj edhe gjykata nuk u lëshua në këtë pjesë, dhe përfundimisht gjykata ka ardhur në përfundimin se në rastin konkret vendimi i atakuar, nga pala kundërshtarë është i drejtë kur ka vepruar dhe ka zbatuar drejtë dispozitën ligjore të cituar me lartë dhe gjykata bazuar në vërtetimin e kësaj gjendje faktike dhe në pajtim me dispozitën e nenit 54.1 lidhur me nenin 74 të Ligjit nr. 06/L- 086 për Dhomën e Posaçme në çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Shpenzimet Gjyqësore:

Në bazë të nenit 62.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti heqë shpenzimet e veta, pasi paditësi e ka humbur kontestin, ndërsa i padituri nuk i ka kërkuar shpenzimet.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme, brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

G j y q t a r e

Ganimete Puka